



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Nr. 358 Prot.

KONTRATË SHËRBIMI
“HARTIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT”
PËR BASHKINË TEPELENË

Në Tepelenë, sot më datë 18 / 11 / 2016, lidhet kjo kontratë ndërmjet:

PALËVE KONTRAKTUESE

AUTORITETI KONTRAKTOR:

BASHKIA TEPELENË, përfaqësuar nga Kryetari i bashkisë, z.Tërmet Peçi

Adresa: Sheshi “Lord Bajron” Tepelenë.

Tel/Fax: 081422470

NIPT: K493225290

KONTRAKTORI:

INFRAKONSULT SHPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, z.Redë Struga

Adresa: Njësia Bashkiake nr.8, Rr.Qemal Stafa, Pallati 25, Hyrja 4, Apartamenti 4,
përballë “Qendrës Lincoln” Tiranë.

Tel/fax: 0689010844

NIPT: L21512022F

Licence: N. 6769/6

Palët bien dakort për sa më poshtë:

BASHKIA TEPELENË

1

INFRAKONSULT SHPK

NENI 1
OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 - Objekti i kësaj kontrate është kryerja e shërbimit, hartimi i projekteve të zbatimit për Bashkinë Tepelenë, si më poshtë:

- Hartimi i projektit të zbatimit: Rikonstruksioni i rrugës "Ago Çeli", rrugës së re dhe rikonceptimi i palestrës të lagjes "15 Shtatori".

NENI 2
DOKUMENTET E KONTRATËS

2.1 - Dokumentet e mëposhtme do të përbëjnë kontratën midis *Autoritetit Kontraktor* dhe *Kontraktorit*, secili dokument do të konsiderohet si pjesë integrale e kontratës:

- Formulartë i sigurimit të kontratës, në shumën 10% e vlerës së kontratës;
- Oferta ekonomike.

2.2 - Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në KPK dhe KVK.

2.3 - Dokumentat e lartpërmendura në përfundim të kontratës mbeten pronë e *Autoritetit Kontraktor*.

NENI 3
ÇMIMI I KONTRATËS

3.1 - Çmimi i kontratës është çmimi i ofruar në ofertën e *Kontraktorit* dhe i pranuar nga *Autoriteti Kontraktor*, me vlerë të përgjithshme prej **3.400.000** (tremilionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH.

NENI 4
KOHËZGJATJA E KONTRATËS

4.1 - Kjo kontratë do të realizohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e nënshkrimit të saj nga palët.

NENI 5
MËNYRA DHE AFATET E PAGESËS

5.1 - Pagesa do të kryhet brenda 30 ditëve nga dita janë marrë në dorëzim shërbimet.

5.2 - Pagesa do të kryhet me urdhër xhirimi në llogarinë e *Kontraktorit* kundrejt paraqitjes zyrtare të faturës tatimore.

5.3 - Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e *Autoritetit Kontraktor*.



5.4 - Pagesat bëhen në monedhën shqiptare.

5.5 - ~~Kontraktori~~ është i detyruar të paguajë vetë të gjitha taksat në bazë të ligjeve në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.

NENI 6 **SIGURIMI I KONTRATËS**

6.1 - ~~Kontraktori~~ duhet t'i dorëzojë *Autoritetit Kontraktor* sigurimin e kontratës, në vlerën 10% e vlerës së ofertës, në formën e policës së sigurimit.

6.2 - Dështimi për të dhënë sigurimin e kontratës në formën dhe në shumën e kërkuar do të rezultojë në anulimin e kontratës.

6.3 - Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet *Autoritetit Kontraktor* si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i *Kontraktorit* në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

6.4 - Sigurimi i kontratës do t'i kthehet *Kontraktorit* jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së shërbimeve.

NENI 7 **DETYRIMET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË** **KONTRAKTORIT**

7.1 - ~~Kontraktori~~ duhet t'i kryejë shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.

7.2 - ~~Kontraktori~~ duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 - ~~Kontraktori~~ duhet t'i paraqesë *Autoritetit Kontraktor* të gjitha shërbimet, së bashku me të gjitha dokumentet, studimet, skicimet dhe planimetritë.

NENI 8 **LEJET DHE LICENSAT**

8.1 - ~~Kontraktori~~ do të jetë përgjegjës për aplikimin për Leje Ndërtimi sipas kërkesave të ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në funksion të tij, për kryerjen e shërbimeve në këtë kontratë.





NENI 9

SIGURACIONI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

9.1- *Kontraktori* duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për të zhdëmtuar *Autoritetin Kontraktor* për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.

NENI 10

VONESA NË ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT.

10.1 - Me nënshkrimin e kësaj kontrate *Kontraktori* duhet të fillojë menjëherë zbatimin e saj.

10.2 - Me përjashtim të rasteve kur *Autoriteti Kontraktor* është dakort për zgjatjen e afateve të kontratës, ka të drejtë të likujdojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse *Kontraktori* dështon në kryerjen e shërbimeve brenda afatit të specifikuar në kontratë.

10.3 - *Autoriteti Kontraktor* mund të zbresë shumën e dëmeve të likujdueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj *Kontraktorit*. Në rast të tillë *Autoriteti Kontraktor* duhet t'i japë *Kontraktorit* njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

NENI 11

LIKUIDIMI I DËMEVE PËR DORËZIMIN E VONUAR

11.1 - Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

NENI 12

NRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

12.1 - Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa *Kontraktuesi* është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

NENI 13

FORCAT MADHORE

13.1 - *Kontraktori* nuk mban përgjegjësi nëse dështimi në përmbushjen e detyrimeve të kontratës ose vonesat për zbatim e saj vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

13.2 - Nëse ndodh një situatë e forcës madhore, *Kontraktori* duhet të njoftojë menjëherë *Autoritetin Kontraktor*. *Kontraktori* duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

NENI 14 **NDËRPRERJA E KONTRATËS**

14.1 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse, *Kontraktori* dështon pa shkaqe të arsyeshme në kryerjen e shërbimeve brenda periudhës së specifikuar në kontratë apo brenda zgjatjes së dhënë ose dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet t'i japë *Kontraktorit* njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim si dhe t'i japë atij 10 ditë kohë të ndreqë mosplotësimin, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

14.2 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse *Kontraktori* falimenton ose bëhet i pafatë të paguajë. Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet t'i japë *Kontraktorit* njoftim me shkrim për ndërprejen.

14.3 - *Autoriteti Kontraktor* mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Në këtë rast *Autoriteti Kontraktor* duhet të lajmërojë me shkrim *Kontraktorin* për ndërprerjen dhe duhet t'i paguajë atij (*Kontraktorit*) të gjitha shërbimet e kryera përpara ndërprerjes së kontratës si dhe do t'i kërkojë të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

NENI 15 **KOMUNIKIMI**

15.1 - Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim.

15.2 - Njoftimi është efektiv vetëm pasi t'i dorëzohet palës tjetër.

NENI 16 **LLOGARITJA E AFATEVE**

16.1 - Të gjitha referencat e ditëve do të jenë dite kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

NENI 17
BAZA LIGJORE

17.1 - Kjo kontratë është hartuar në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar dhe Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) të miratuar nga APP.

17.2 - Për çdo mungesë parashikimi në këtë kontratë, palët do t’i referohen KPK dhe KVK, që janë pjesë e Dokumentave Standarte të Tenderit.

NENI 18
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

18.1 - Palët nënshkruese të kontratës duhet të bëjnë përpjekje që mosmarrëveshjet të zgjidhin me mirekuptim ndërmjet tyre, në të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët do t’i drejtohen gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

NENI 19
VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

19.1 - Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga dita e nënshkrimit nga palët .

19.2 - Kontrata përpilohet në 5 (pesë) kopje, me vlerë dhe përmbajtje të njëjtë juridike, nga të cilat 4 (katër) kopje i mban *Autoriteti Kontraktor* dhe 1 (një) kopje e mban *Kontraktori*.

PALËT KONTRAKTUESE:

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA TEPELENË
KRYETARI I BASHKISË


KONTRAKTORI
INFRAKONSULT SHPK
DREJTUESI LIGJOR

TËRMET PEÇISHQIPËRISE



BASHKIA E TEPELENË

REDI STRUGA



INFRAKONSULT SHPK



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA TEPELENE

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelene Tel. Fax-8142470

Nr i References

358

Tepelene me, 18.11.2016

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: **“ Projekt –Preventiv te zbatimit te objektit “rikonstruksion I rruges Ago Celi dhe rikonceptim I palestres” si dhe kriteret tekniko ligjore sipas PKZHT ”**

Kjo Kontratë është lidhur më 18.11.2016 midis Bashkia Tepelene , qe me poshte quhet Autoritet kontraktor) perfaqesuar nga kryetari Termet PEÇI dhe **Operatori Ekonomik " IfraKonsult" shpk** (qe me poshte quhet kontraktuesi) me adrese Tirane , NIPTI L21512022F , i cili merr persiper te realizoje objektin e kontrates.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar Prokurimit : Projekt –Preventiv te zbatimit te objektit “rikonstruksion I rruges Ago Celi dhe rikonceptim I palestres” si dhe kriteret tekniko ligjore sipas PKZHT ”.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **07.11.2016** bie dakord të realizojë Sherbimin, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

Këtë Formular Kontrate, Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi, Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit, Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike, Preventivin e Kostove, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Kushtet e Veçanta të Kontratës, Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor , Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **3.400.000 (tremilion e katerqind mije) pa tvsh** dhe **4.080.000 (katermilion e tetedhete mije) me tvsh.**

Palët bien dakord si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate 10% te vleres se kontrates si garanci për realizimin e Punëve në shumën prej: 340.000 (treqind e dyzet mijë) dhe në formën e:

a) garanci bankare e pakushtëzuar,

b) garanci sigurimi

në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.

2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.

4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.

5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 18/ 11/ 2016/ palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

KONTRAKTUESI


AUTORITETI KONTRAKTOR

"IfraKonsult" shpk"

BASHKIA TEPELENE

ADMINISTRATOR

KRYETARI

Red. Struga

IfraKONSULT
Shërbime Inxhinierike
Tirane - Albania

